



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

## **Politika për parandalimin e braktisjes së shkollimit**

### **HYRJE**

Vijueshmëria e shkollimit në Kosovë ka shënuar përmirësim pas vitit 1999, por megjithatë, shkalla e tanishme e braktisjes së shkollimit të obligueshëm vazhdon të jetë brengë për shoqërinë tonë. Në vitin shkollor 1995/96 prej numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor, nuk ishin të evidentuar në fund të vitit shkollor 2,18 %. Kur këtij numri i shtohet edhe numri i nxënësve të pa notuar që arrin përqindjen 4,43%, atëherë del se brenda vitit shkollor procesin mësimor e kanë ndërprerë 6,61 %.<sup>1</sup>

Sipas të dhënave të SMIA për vitin shkollor 2006/07, në këtë vit shkollor shkalla e braktisjes ishte 0.9%, ndërsa braktisja e femrave ishte 1.1%. Këto të dhëna janë të njëjta me një vit më parë, ndërsa, në vitin shkollor 2004/05, sipas SMIA, shkalla e braktisjes ishte 1.17%<sup>2</sup>. Pra vërehet një rënie e lehtë e shkallës së braktisjes, gjë që jep shpresë se intervenimet në këtë fushë mund të qojnë në rezultate edhe më të mira.

Shkaqet e braktisjes janë të shumta dhe të ndërlydhura mes vete. Në Kosovë situata ekonomike është e rënduar. Kjo situatë pasqyrohet me shkallën e lartë të varfërisë (45% varfëri dhe 15 % varfëri ekstreme<sup>3</sup>) që i vë shumë familje në sfidën e dërgimit të fëmijëve në shkollë, e për më tepër mbajtjes së tyre në shkollë së paku gjatë shkollimit të obliguar. Po ashtu, situata e këtyllë ekonomike nuk krijon mundësi për investime në fushën e arsimit, si në aspektin e cilësisë, ashtu edhe në aspektin e infrastrukturës. Lëvizjet e pakontrolluara demografike fshat-qytet e kanë vështirësuar procesin e mësimin, duke stërngarkuar shkollat urbane. Sistemi i arsimit, pas luftës nuk ka pasur trajtimin e duhur institucional. Kjo ka ulur vlerën e arsimit në shoqëri dhe ka shkëputur në masë lidhjen e perspektivës së qytetarit me arsimimin. Të gjitha këto dhe të tjera realitete, përbëjnë spektrin e faktorëve që ndikojnë në braktisjen e shkollimit.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin e obligueshëm është një çështje në agjendën botërore. Kjo agjendë është përcaktuar me dy dokumente ndërkombëtare: Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit dhe Qëllimet e Arsimimit për të Gjithë.

Në Kosovë, po ashtu, po bëhen përpjekje që të krijohen kushtet për gjithëpërfshirje të fëmijëve në arsimin e obligueshëm. Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar në Kosovë ka definuar një objektivë strategjike për gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim të diversitetit në arsim. Kjo objektivë është konkretizuar me një masë e cila ka të bëjë me hartimin e politikave që sigurojnë përfshirje të plotë të fëmijëve në sistemin e arsimit. Në anën tjetër po bëhen përpjekje përmes projekteve të ndryshme që të trajtohet problemi i braktisjes së shkollimit, sidomos nga nxënësit që vijnë prej grupeve të rrezikuara (të varfrit, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga grupet minoritare, vajzat, fëmijët që punojnë, etj). Në këtë kuadër vlen të përmenden intervenimet e financuara nga Banka Botërore, UNICEF-i dhe CRS në drejtim të parandalimit të braktisjes. Në vitin 2005 MASHT-i ka hartuar doracakun "Të gjithë në shkollë", i cili përmban udhëzime praktike për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkollë. Në vitin 2007 është hartuar doracaku i cili trajton çështjet e parandalimit të braktisjes për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

### **ÇËSHITJA KRYESORE**

<sup>1</sup> Burimi: Bajram Shatri, Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX, Prishtinë, Libri Shkollor, 2006

<sup>2</sup> Burimi: Të gjithë në shkollë, doracak, pako strategjish, Prishtinë, tetor 2005

<sup>3</sup> Burimi: Raporti i Bankës Botërore dhe Entit të Statistikës së Kosovës, 3 tetor 2007

Braktisja paraqet një dukuri që pengon zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Në shtrirje më afatgjate braktisja e shkollimit ndikon në marginalizimin e individëve dhe të grupeve shoqërore si dhe në shfaqjen dhe shtimin e dukurive negative në shoqëri. Reagimi ndaj braktisjes në shkollimin e rregullt dhe parandalimi i saj paraqet obligim shoqëror, por edhe obligim ligjor të autoriteteve qendrore dhe lokale. Për adresimin e kësaj çështje është i nevojshëm bashkëveprimi i të gjitha institucioneve dhe palëve tjera të interesit, duke përfshirë fuqishëm edhe komunitetin

## **QËLLIMET E POLITIKËS**

*Të parandalohet braktisja në arsimin e obligueshëm përmes mobilizimit të vazhdueshëm të palëve me interes, si dhe përmes zbatimit të masave ndërgjegjësuese dhe ligjore*

## **OPSIONET E MUNDSHME**

Për të arritur qëllimin e kësaj politike, janë marrë para sysh këto opsione:

### **1. Gjenden modalitete për të stimuluar vijueshmërinë e rregullt në shkollim (Qasja stimuluese)**

Përvojat më të mira botërore tregojnë se stimulimi i fëmijëve dhe familjeve të tyre për vijimin e shkollimit ka dhënë rezultate mjaft të mira, ndërsa rezultate pak më modeste janë arritur si efekt i stimulimit të shkollave. Andaj, duhen të gjenden modalitete për të stimuluar vijueshmërinë e rregullt në shkollim, sidomos për fëmijët që vijnë nga grupet e rrezikuara (vajzat, të varfrit, fëmijët nga viset rurale, fëmijët që punojnë, pakicat kombëtare, fëmijët me paaftësi)

### **2. Rritet angazhimi në ndërgjegjësimin e komunitetit për rolin dhe rëndësinë e tij në vijueshmërinë e rregullt të fëmijëve në shkollim (Qasja vetëdijesuese)**

Problemit të braktisjes mund t'i adresohemi me sukses pos tjerash, nëse arrijmë që të sensibilizojmë atë pjesë të komunitetit që arsimimin e fëmijëve nuk e sheh si çështje me vlerë primare për mirëqenien e vet. Prandaj, si mënyrë e mirë veprimi shihet krijimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm mes institucioneve dhe komunitetit, si dhe angazhimi në ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë që ka në vijueshmërinë e rregullt të fëmijëve në shkollim.

### **3. Ndërmerren masa ligjore ndaj prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve braktisës (Qasja ndëshkuese)**

Duke marrë parasysh se numri më i madh i braktisësve potencialë i takon kategorisë së të varfërve, zbatimi i masave ndëshkuese duhet të mbetet si opsioni i fundit për veprim.

## **POLITIKA E ZGJEDHUR DHE IMPLIKIMET**

Gjetja e modaliteteve për të stimuluar vijueshmërinë e rregullt në shkollim, sidomos për grupet e rrezikuara, si dhe angazhimi në ndërgjegjësimin e komunitetit për rolin dhe rëndësinë e tij në vijueshmërinë e rregullt të fëmijëve në shkollim janë opsione të përshtatshme, që fuqizojnë njëra-tjetrën në kursin e zgjedhur të veprimit. Komunitetit do t'i ofrohen përfitime, por edhe do të sigurohet pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetit në proces, si kusht i domosdoshëm për qëndrueshmëri të ndërmarrjes. Zbatimi i kësaj politike duhet të mbështetet me infrastrukturë ligjore dytësore si udhëzime administrative, rregullore, rekomandime, etj.

Ky kurs veprimi përputhet me prioritetet e qeverisë, të cilat më së miri specifikohen në objektivën e tretë zhvillimore në kuadër të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar në Kosovë – Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim

## ZBATIMI/IMPLEMENTIMI

### 1. Gjenden modalitete për të stimuluar vijueshmërinë e rregullt në shkollim

#### 1.1 Krijohen mekanizma funksionalë brenda shkollës për trajtimin e rasteve të braktisjes

Themelohen ekipe në nivel shkolle për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes. Këto ekipe do të kenë në përbërje të vet përfaqësues nga mësimdhënësit, prindërit, nxënësit, përfaqësues të OJQ-ve që punojnë në këtë fushë, Qendrat për Punë Sociale, etj. Në fokus të këtyre ekipeve do të jetë identifikimi i rasteve të rrezikut nga braktisja dhe rasteve të braktisjes. MASHT duhet të nxjerrë një udhëzim administrativ për themelimin dhe funksionimin e këtyre ekipeve.

#### 1.2 Hartohen programe të veçanta shkollore për trajtimin e nxënësve që kanë braktisur shkollimin dhe nxënësve që janë braktisës potencialë.

Këto programe mbështeten në organizimin e aktiviteteve jashtëmësimore, realizimin e projekteve të tipit “ndihmë shoku-shokut”, përfshirjen e prindërve profesionistë në procesin e mësimit, sigurimin e mësimit plotësues dhe adaptimin e metodave mësimore për këta fëmijë.

#### 1.3 Stimulohen nxënësit dhe familjet për vijimin e rregullt të shkollimit

Stimulimi i nxënësve bëhet përmes sigurimit të ndihmës për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të veçanta (sport, muzikë, art, kulturë, etj). Prindërit stimulohen përmes programeve të punësimit, përmes lidhjes së përfitimit nga skemat e ndihmës sociale me dërgimin me rregull të fëmijëve në shkollë, përmes sigurimit të teksteve shkollore dhe transportit, etj. Për të siguruar mjetet financiare të nevojshme, përveç fondeve qeveritare, do të shfrytëzohen edhe donacionet, si dhe resurset komunitare.

### 2. Rritet angazhimi në ndërgjegjësimin e komunitetit për rolin dhe rëndësinë e tij në vijueshmërinë e rregullt të fëmijëve në shkollim

#### 2.1 Organizohen fushata sensibilizimi për rëndësinë e komunitetit në sigurimin e vijueshmërisë së rregullt në shkollim

Ndërmerret një fushatë në nivel vendi, me theks të veçantë në ato treva ku ka probleme të theksuara në braktisje. Fushata do të përfshijë prodhimin e materialeve propaganduese, vizitat familjeve, organizimin e debateve me komunitetin, etj. Rekomandohet që në organizimin e këtyre fushatave të angazhohen aktivisht prindërit.

Fushatat e sensibilizimit shndërrohen në fushata të përvitshme që realizohen përmes “javës kundër braktisjes”.

Zbatimi i kësaj politike nuk kërkon implikime të mëdha buxhetore. Më tepër nevojitet vullneti i mirë i palëve të interesit dhe bashkëpunimi efikas mes tyre.

## VLERËSIMI

Vlerësimi i zbatimit të kësaj politike do të bëhet në baza vjetore duke u shërbyer me të dhëna statistikore dhe të dhëna nga burime të tjera. Për shembull kjo mund të realizohet si një aktivitet i “javës kundër braktisjes”.

**Hartuesit:**

- ❖ Xhafer Xhaferi – Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencë dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
- ❖ Dukagjin Pupovci – Qendra për Arsim e Kosovës
- ❖ Veton Sylhasi – Shoqata Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës (KAHCR)
- ❖ Hafiz Lekaj – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
- ❖ Shkumbin Arifi – Catholic Relief Services (CRS)
- ❖ Sahit Berisha – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)
- ❖ Fetah Kasumi - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)
- ❖ Florije Rrecaj - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencë dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
- ❖ Sali Maliqi - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencë dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
- ❖ Reshit Kushaj - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencë dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)